



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 240, datë 13.11.2024

PËR
“MIRATIMIN E QËNDRIMIT NË DETYRË TË MAGJISTRATIT HYSEN KETA”

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), me pjesëmarrjen e:

1. Znj. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Znj. Ledina RIZA	Anëtar
3. Znj. Arta MANDRO	Anëtar
4. Z. Zeqir HODA	Anëtar
5. Z. Sokol STOJANI	Anëtar
6. Z. Moisi DUDA	Anëtar
7. Z. Vatë STAKA	Anëtar
8. Z. Olger EMINAJ	Anëtar
9. Z. Erind GERMENJI	Anëtar
10. Z. Erind MERKURI	Anëtar
11. Z. Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 13/11/2024, konform procedurës së përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 18 e vijues të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për miratimin e qëndrimit në detyrë të magjistratit Hysen Keta”.



BAZA LIGJORE:

- i. Neni 64 pika 5, Ligji Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- ii. Në kërkesën nr.1331 prot., datë 06.06.2024 të zotit Hysen Keta, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- i. Relacioni shoqërues Nr. 2519, datë 07/11.2024, i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës;
- ii. Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

Pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, është administruar me nr. 1331 prot., datë 06.06.2024, kërkesa e zotit Hysen Keta, për vijimin e ushtrimit të detyrës së prokurorit deri në moshën 70 vjeç.

Kjo kërkesë bazohet në nenin 64, pika 5 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i cili parashikon se:

“Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç. Magjistrati, me kërkesën e tij, mund të qëndrojë në detyrë deri në moshën 70 vjeç. Kërkesa për qëndrimin në detyrë paraqitet jo më vonë se 6 muaj përpara plotësimit të moshës për pension. Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose moshën 70 vjeç, në rastet kur ka kërkuar të qëndrojë në detyrë deri në këtë moshë”.

Zoti Hysen Keta është i datëlindjes 04.04.1958, për rrjedhojë kërkuesi mbush moshën 67 vjeç me datë 04.04.2025. Kërkesa e tij për vijimin e qëndrimit në detyrë është paraqitur me datë 06.06.2024, duke qenë në përputhje me afatin e 6-mujor të përcaktuar nga neni i sipërcituar, për paraqitjen e kërkesës.

Këshilli, në analizë të situatës në sistemin e prokurorisë, ku sikurse dihen mungesat në organikat e të gjitha prokurorive janë të mëdha, si dhe duke pasur parasysh se zoti Keta është një prokuror me përvojë të gjatë në sistem, i vlerësuar shumë mirë në vlerësimin e fundit, (në referim të dosjes personale, administruar nga zyra e burimeve njerëzore pranë KLP-së), vlerëson se kontributi i mëtejshëm i zotit Keta, edhe për një periudhë tjetër 3-vjeçare është i nevojshëm.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 64 të Ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,
Në kërkesën nr.1331 prot., datë 06.06.2024 të zotit Hysen Keta.

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës dhe miratimin e qëndrimit në detyrë të zotit Hysen Keta, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme, deri në mbushjen e moshës 70 vjeç.
2. Ky vendim i njoftohet zotit Hysen Keta dhe Prokurorit të Përgjithshëm.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 13.11.2024.



KRYETAR

Mirela Bogdani

ANËTAR

Zeqir Hoda

ANËTAR

Moisi Duda

ANËTAR

Erind Germenji

ANËTAR

Arta Mandro

ANËTAR

Vatë Staka

ANËTAR

Erion Fejzulla

ANËTAR

Sokol Stojani

ANËTAR

Ledina Riza

ANËTAR

Olger Eminaj

ANËTAR

Erind Merkuri